

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5619
E shtunë, 3 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, figura të ndritura të qëndresës kombëtare



AFRIM ZHITIA
1965 -1989

FAHRI FAZLIU
1963 -1989

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

MERKELI I PËRGJIGJET LETRËS SË MUSTAFËS, SHPREHET E BRENGOSUR PËR NDRYSHIMIN E KUFIJVE

F. 5

KDI-ja I PREZANTON KQZ-së DIZAJNET E REJA TË FLETËVOTIMEVE

F. 7

PJETËR NDRECAJ DËNOHET ME 24 VJET BURGIM PËR VRASJEN E GRUAS DHE VAJZËS

F. 3

EKONOMI

ATK-ja GRUMBULLOI 391.6 MILIONË EURO

F. 9

BASHKIMI DOGANOR DHE POLICOR SHQIPËRI - KOSOVË SË SHPEJTI DO TË BËHET REALITET

F. 9

KULTURË

PROF. DR. EQREM ZENELAJ, VEPRAT E TIJ NJË AKADEMI NË VETE

F. 13



Nga Hazir MEHMETI, Vjenë

HAPET EKSPOZITA 'ANTIKITETI I QYTETIT TË RAHOVECIT'

F. 16

SPORT

HUMBJA NGA PRISHTINA, E PAPRANUESHME PËR DRENICËN

F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ | FAQE 4-5

Opozita ishte e interesuar të dështojë rezoluta për dialogun

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë fajtorë opozitën për dështimin e rezolutës për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) nuk ishin të interesuara ta arrijnë konsensusin për këtë çështje, duke shtuar se këto subjekte në mënyrë ta pashpjegueshme kanë refuzuar propozimet e pozitës për plotësimin e kësaj rezolute. Nitaj ka thënë se nuk e ka kuptuar mungesën e liderit të LV-së, Albin Kurti, në votimin e rezolutës. Ai ka treguar se pozita nuk do të ndalet së kërkuari konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Kurse sa i përket kërkesës së opozitës për zgjedhje të reja, Nitaj ka thënë se edhe 100 herë po të mbahen zgjedhjet, situata do të jetë e njëjtë



Qehaja: Kosova në pozicion të vështirë, por ka gjasa për anëtarësim në Interpol

Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet që Republika e Kosovës të bëhet anëtare e organizatës më të madhe ndërkombëtare të policisë, Interpol. Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova është në pozicion të vështirë por, sipas tij, kësaj radhe ka gjasa më të mëdha për anëtarësim në Interpol. Megjithatë në këtë drejtim ofensiva e diplomacisë serbe është mjaftë e fuqishme, Qehaja ka thënë se këtë herë Kosova do të ketë mundësi të anëtarësohet në këtë organizatë

FAQE 3



Letra dëshpëruese nga burgu e Sylejman Selimit: Harrojeni që ekzistoj

FAQE 2



Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, në letrën drejtuar avokatit Tomë Gashi ka bërë me dije se ka marrë vendim që tash e tutje të mos ketë përfaqësim ligjor

pasi, siç thotë ai, procesi kundër tij është i montuar nga politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Letra dëshpëruese nga burgu e Sylejman Selimit: Harrojeni që ekzistoj



Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi, në letrën drejtuar avokatit Tomë Gashi, ka bërë me dije se ka marrë vendim që tash e tutje të mos ketë përfaqësim ligjor pasi, siç thotë ai, procesi kundër tij është i montuar nga politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë


PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Sylejman Selimi, ka reaguar ndaj vendimit të fundit të Gjykatës Supreme e cila e refuzoi kërkesën e tij për lirim me kusht. Në letrën e tij drejtuar avokatit Tomë Gashi, Selimi bën me dije se ka marrë vendim që tash e tutje të mos ketë përfaqësim ligjor pasi, siç thotë ai, procesi kundër tij është i montuar nga politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë. Në letrën e shkruar me dorë, Selimi thotë se padrejtësinë ndaj tij do ta dëshmojë koha dhe se ata që kanë marrë pjesë në këtë montim politik, duke ndërhyrë në drejtësi, një ditë kanë për t'u turpëruar para familjeve të tyre dhe para qytetarëve të këtij vendi. "I nderuar avokat Tomë Gashi, dua t'ju falënderoj juve, avokatin Smith dhe avokatin Dobruna për punën e palodhshme që keni

bërë që pesë vjet, duke dhënë kontributin tuaj në procesin gjyqësor si në rastin 'Drenica 1' dhe '2', edhe pse ishte vetëm 'Drenica', por që u nda padrejtësisht. Ju dhe ekipi mbrojtës keni dhënë kontribut të jashtëzakonshëm gjatë seancave për ta dëshmuar pafajësinë time dhe grupit 'Drenica 1' dhe '2' dhe i ndihmuat trupit gjyqësor që të dalë e vërteta në rastin tim. Por, fatkeqësisht, i tërë procesi nga fillimi kishte qenë i padrejtë, i njëanshëm dhe politik. Këtë e argumentoi edhe vetë kryetari i trupit gjyqësor të EULEX-it, z. Malcolm Simmons. Fatkeqësisht, i tërë procesi kundër meje po del të jetë proces i montuar nga politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë", ka shkruar Sylejman Selimi. Ai ka shtuar në këtë letër se tash e një kohë të gjatë është duke e pyetur veten pse e kanë penguar në rrugëtimin e tij ndaj proceseve shtetëndërtuese para, gjatë

dhe pas luftës. "Kam qenë bartës i institucioneve dhe bashkëpunues si me përgjegjës të sigurisë ndërkombëtare, por edhe me përgjegjësit e sigurisë vendore. E gjithë veprimtaria ime ka qenë në shërbim të vendit tim. Që të kemi një vend të lirë, demokratik, që i shërben çdo qytetari, pa dallim, një vend ku respektohen të drejtat e të gjithë qytetarëve pa dallim, pra një vend ku sundon ligji, të cilin e kam respektuar dhe do ta respektoj gjithmonë. Por jam i zhgënjyer në drejtësinë e vendit tim, ku tërë jetën time i kam shërbyer me dinjitet e deri në vetëmohim para dhe gjatë luftës për popullin tonë nën organizimin e UÇK-së si komandant i saj", thuhet në letrën e Sylejman Selimit. Ai i është drejtuar edhe me disa fjalë avokatit Tomë Gashi. "I nderuar avokat Tomë Gashi, unë që nga sot e kam marrë një vendim, që të mos kem edhe më

tutje përfaqësues ligjor (avokat). Nga sot nuk dua të kem avokat mbrojtës. Më vjen keq që deri më tani keni qenë jashtëzakonisht aktiv në mbrojtjen e pafajësisë sime, duke e dëshmuar me fakte keni bërë të pamundurën për ta ndihmuar edhe drejtësinë (njerëzit e saj) për ta vënë drejtësinë. Kjo nuk po ndodh derisa kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vendit i cili edhe është organi më i lartë juridik dhe nuk zbatohet, atëherë çfarë të themi, çfarë të bëjmë, kënd ta pyesim, ku të kërkojmë drejtësi? Ku? Politikës?! Jo, kurrë. I nderuar Tomë, nuk më duhet avokat derisa politika dhe politikanët në veçanti, të cilët vendosin për kënd dhe njerëz të caktuar të bëhet gjyqi dhe sa duhet të mbahen në izolim", ka shkruar Sylejman Selimi, i cili e ka falënderuar ekipin mbrojtës të tij. "Edhe një herë ju falënderoj juve dhe gjithë ekipin mbrojtës dhe avokatët e të akuzuarve të tjerë në rastin

'Drenica 1' dhe '2' për kontributin dhe përpjekjet tuaja për zbardhjen e së vërtetës që dëshmon pafajësinë tonë. Te grupi 'Drenica 1' dhe '2'. Të nderuar avokatë, në këtë proces gjyqësor nuk pati drejtësi, por të gjithë jemi të pajtimt se ka qenë i përgatitur dhe i montuar politikisht dhe për këtë do të dëshmojë koha. Kurse për ata të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë montim politik, duke ndërhyrë në drejtësi, një ditë kanë për t'u turpëruar para familjeve të tyre dhe para qytetarëve të këtij vendi. Koha do të dëshmojë. Edhe një herë faleminderit gjithë ekipit mbrojtës (avokat i nderuar) të rastit 'Drenica 1'. Iu kisha lutur të gjithë atyre që në një formë po sjellin ndërmend emrin tim, mos ta përmendin dhe le të harrojnë që ekzistoj. Drejtësia herët apo vonë do ta thotë fjalën e vet. Me respekt, Sylejman Selimi, Dubravë, 27. 10. 2018", ka shkruar ish-komandanti i UÇK-së, Sylejman Selimi.




ARKEP-i thotë se ka progres në zbatimin e plotë të kodit +383

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Bordi Drejtues i Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në takimin e mbajtur të premten ka shqyrtuar nivelin e zbatimit të kodit telefonik shtetëror +383. Në këtë takim është konstatuar progresi i arritur në drejtëm të zbatimit të

plotë të kodit +383, me theks të veçantë në heqjen nga përdorimi të kodit +381 si dhe hapjen për përdorim të kodit +383 nga operatorët si për thirrjet e origjinuara nga Kosova, po ashtu për thirrjet terminuara në Kosovë. "ARKEP-i ka trajtuar kërkesat për shtyrje të afatit të largimit të kodeve të huaja

në përdorim në Republikën e Kosovës si kode paralele, respektivisht kodit +377 nga operatori Telekom i Kosovës dhe kodit +386 nga operatori IPKO dhe ka vendosur që të mos pranojë kërkesat për shtyrje të afatit. Si rezultat, në këtë takim është vendosur që në respektim të ligjit për

komunikimet elektronike t'u shqiptohet vërejtja e fundit për zbatim të kodit të gjithë operatorëve si masë paraprake e domosdoshme para përcaktimit të sanksioneve ekonomike si edhe të përcaktohet masa sanksionuese në shumë prej 10 000 eurosh në baza mujore efektive



prej datës 15 janar 2018 për operatorët që nuk largojnë kodet e huaja nga përdorimi", është thënë në komunikatën e ARKEP-it.

Institucionet shtetërore kanë bërë përgatitjet e nevojshme për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

Qehaja: Kosova në pozicion të vështirë, por ka gjasa për anëtarësim në Interpol

Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet që Republika e Kosovës të bëhet anëtare e organizatës më të madhe ndërkombëtare të policisë, Interpol. Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova është në pozicion të vështirë por, sipas tij, kësaj radhe ka gjasa më të mëdha për anëtarësim në Interpol. Megjithëse në këtë drejtim ofensiva e diplomacisë serbe është mjaft e fuqishme, Qehaja ka thënë se këtë herë Kosova do të ketë mundësi të anëtarësohet në këtë organizatë

bashkëpunimit ndërshtetëror në këtë drejtim. Pjesë e menjëherëshme e agjendës sime janë kontaktet me përfaqësues ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe atashetë policore në kuadër të misionëve diplomatike në Kosovë. Janë dhënë garanci të forta nga shtete të ndryshme, se jo vetëm që do ta japin votën e tyre pro anëtarësimin në Interpol, por do t'i shohin edhe mundësitë e lobimit ndër anëtarë të tjerë. Bashkëpunimi ndërmjet policive është garanci që në botë nuk do të lejohen 'vrime të zeza' në të cilat pamundësohet qasja e Interpolit. Secili shtet anëtar në Interpol nuk duhet ta shikojë anëtarësimin vetëm si obligim karshi sigurisë ndërkombëtare, por edhe të trajtojë qartë përfitimet dhe përparësitë që krijohen për sigurinë kombëtare dhe për sundimin e rendit dhe ligjit brenda shtetit.

Edhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë të premtën për gazetën "Epoka e re" se Republika e Kosovës është

në pozicion të vështirë por, sipas tij, këtë herë ka gjasa më të mëdha për anëtarësim në Interpol. Megjithëse në këtë drejtim ofensiva e diplomacisë serbe është mjaftë e fuqishme, Qehaja ka thënë se këtë herë Kosova do të ketë mundësi të anëtarësohet në organizatën më të madhe ndërkombëtare të policisë. "Mendoj se këtë herë janë bërë përgatitjet paraprake që të bëhet një lobim për Interpolin sepse anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë që ka të bëjë me sigurinë dhe me policinë ndërkombëtare ka një rëndësi të madhe. Unë shpresoj se këtë herë do të kemi mundësi të anëtarësohemi, megjithëse ofensiva e diplomacisë serbe në këtë drejtim është një kundërvënie mjaft e fuqishme kundër asaj që ne jemi duke e bërë për anëtarësim. Ata i kanë marrë të gjitha detajet që ne i kemi sa iu përket përgatitjeve dhe dërgimit të njerëzve tanë për lobim jashtë. Kështu që është një pozicion bukur i vështirë por, sidoqoftë, mendoj se kësaj herë

gjasat për anëtarësim në Interpol janë shumë më të mëdha se në vitin e kaluar", është shprehur ai. Qehaja ka vlerësuar se Kosova do të ketë përfitime të mëdha në aspektin e sigurisë nga anëtarësimi në Interpol. Sipas tij, vendi ynë do të jetë një kontribuues i madh i çështjeve të sigurisë jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. "Me këtë rast mendoj se Kosova do të ketë përfitime të mëdha në aspektin e sigurisë sepse do të jetë një kontribuuese e madhe e çështjeve të sigurisë jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Dhe kuptohet se do të kemi mundësi që të gjithë ata që kanë bërë krime dhe gjëra jo të mira në Kosovë t'i përndjekim dhe të ndërmarrim masa kundër tyre. Nuk kemi kurrfarë dëshire për hakmarrje ndaj serbëve apo dikujt tjetër, mirëpo do të ndërmerren masa ndaj atyre që kanë bërë vepra penale. Prandaj mendoj se kontributi ynë do të jetë shumë më i madh po qe se jemi anëtarë të Interpolit", ka deklaruar Qehaja.

**EPOKA
ERE**Shqipëri **HETEMI**

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Çështja e pranimit të Kosovës në Interpol do të jetë pjesë e agjendës së Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate që do të mbahet në fund të këtij muaji në Dubai. Me këtë rast zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që Republika e Kosovës të bëhet anëtare e organizatës më të madhe ndërkombëtare të policisë.

Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka treguar se ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe të koordinuar mirë për pranimin e Kosovës në Interpol. "Ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe mirë të koordinuar ndërmjet ministrive, Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera. Janë angazhuar ekspertë të cilët me lobimin e tyre dhe argumentet që ofrojnë, po përmbysin pretendimet e ndryshme nga zëra të caktuar të cilët mund të kenë rezerva lidhur me pranimin e Kosovës në Interpol. Që nga ardhja ime në detyrë fillimisht jam informuar lidhur me angazhimet e të gjithë aktorëve relevantë të inkuadruar në lobimin për Interpol, më pas edhe jam inkuadruar në këto aktivitete së bashku me kabinetin tim", ka deklaruar Mustafa ditë më parë në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re".

Sipas ministrit Mustafa, janë dhënë garanci të forta nga shtete të ndryshme, se jo vetëm që do ta

japin votën e tyre pro anëtarësimin të Kosovës në Interpol, por do të shohin edhe mundësitë e lobimit të anëtarë të tjerë. Ai ka theksuar se bashkëpunimi ndërmjet policive është garanci që në botë nuk do të lejohen 'vrime të zeza' në të cilat pamundësohet qasja e Interpolit. "Anëtarësimi në Interpol nuk është thjesht një hap tutje rreth rrumbullakimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës por ai, para së gjithash, prek aspekte të sigurisë dhe të



Pjetër Ndrecaj dënohet me 24 vjet burgim për vrasjen e gruas dhe vajzës

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - I akuzuari për vrasjen e ish-gruas dhe vajzës, Pjetër Ndrecaj, të premtën është dënuar nga Gjykata Themelore

në Gjakovë me 24 vjet burgim efektiv. Ai u dënua me 23 vjet burgim për vrasje të dyfishtë dhe me 2 vjet të tjera për armëmbajtje pa leje. Si për-

fundim, ndaj tij gjykatësi Gëzim Pozhegu shpalli dënim unik në kohëzgjatje prej 24 vjetësh, me ç'rast do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në

paraburgim. Ndaj këtij verdikti të gjykatës ka reaguar Rrjeti i Grave të Kosovës, duke e cilësuar të ulet dënimin. Sipas RrGK-së, Kodi Penal i Kosovës,

përkatësisht neni 179, e përcakton që personi që shkakton vrasjen e anëtarit të familjes apo të fëmijës, dënohet me burgim të përjetshëm.

Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

Opozita ishte e interesuar të d



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë faktore opozitën për dështimin e rezolutës për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) nuk ishin të interesuara ta arrijnë konsensusin për këtë çështje, duke shtuar se këto subjekte në mënyrë ta pashpjegueshme kanë refuzuar propozimet e pozitës për plotësimin e kësaj rezolute. Nitaj ka thënë se nuk e ka kuptuar mungesën e liderit të LV-së, Albin Kurti, në votimin e rezolutës. Ai ka treguar se pozita nuk do të ndalet së kërkuari konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Kurse sa i përket kërkesës së opozitës për zgjedhje të reja, Nitaj ka thënë se edhe 100 herë po të mbahen zgjedhjet, situata do të jetë e njëjtë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ishin të interesuara të dështojë rezoluta e kësaj të fundit për

dialog me Serbinë të enjten në Kuvendin e Kosovës. Ai ka deklaruar se opozita nuk ishte e interesuar të ketë pajtim me pozitën për këtë çështje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se partitë e koalicionit qeverisës ishin të gatshme ta plotësonin me propozime këtë rezolutë por, sipas tij, një gjë e tillë u refuzua nga

Është e resolute për dialogun

jegueshëm i refuzuan. Unë e kam ditur që në mëngjes që rezoluta do të dështonte, sepse dukej se nuk kishte gatishmëri që të kalohej. Edhe sikur të kishin debatuar me javë, nuk do të kishte marrëveshje", ka thënë Nitaj.

Ai nuk ka dashur ta komentojë shumë se pse disa deputetë të LDK-së dhe të LV-së nuk morën pjesë fare në votimin e rezolutës së LDK-së, por ka shtuar se nuk e ka kuptuar mungesën e liderit të LV-së, Albin Kurtit, në këtë votim. Nitaj ka treguar se pozita nuk do të ndalet së kërkuari konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Besoj se nuk do të rreshtin përpjekjet për konsensus. Por, sa i përket ekipit, unë nuk e kuptoj pse Qeveria kërkon votim në kuvend. Ajo e ka mandatin ta caktojë ekipin vetë. Ajo duhet të ketë kujdes që marrëveshjen ta bëjë të atillë që të marrë dy të tretat e votave, se ekipi nuk është punë e Kuvendit. Platforma po", ka vlerësuar Nitaj, duke shtuar se nëse nuk arrihet konsensusi, dikush tjetër do të vendosë për këtë çështje. "Ne ka vite që nuk funksionojmë pa shtytjen e të tjerëve. Po duket se një pjesë e jona votojmë, qoftë edhe për interes të vendit, vetëm kur s'kemi qare. Qeveria e kryeministri janë seriozë në këtë temë, por Kuvendi duhet ta marrë rolin e vet", është shprehur Nitaj. Deputeti i AAK-së ka thënë se nuk është bllokuar procesi për shkak të zgjedhjeve, por për shkak të vetëdijes që kemi.

"Epoka e re": Z. Nitaj, të enjten ka dështuar edhe një përpjekje e Kuvendit të Kosovës për të arritur një konsensus për dialogun, ku opozita nuk arriti t'i marrë votat e nevojshme për ta miratuar projektrezolutën e propozuar nga LDK-ja. Pse pozita nuk e përkrahu këtë iniciativë të opozitës?

Nitaj: Sepse opozita nuk ishte e interesuar të kishte pajtim për këtë çështje, sepse duket se ishte e interesuar të dështojë. Për LDK-në dhe LV-në më e rëndësishme ishte forma sesa përmbajtja. Ata e kishin një propozim që rezoluta të plotësohej edhe me pika të shumicës, që ishin shumë korrekte, të plota dhe të favorshme, por pashpjegueshëm i refuzuan. Unë e kam ditur që në mëngjes se rezoluta do të dështonte, sepse dukej se nuk kishte gatishmëri të kalohej. Edhe sikur të kishin debatuar me javë nuk do të kishte marrëveshje. Për mua natyrisht është e pakuptueshme gjithë dita e

djeshme. Të dëgjosh gjithë ditën se si flasin diçka e votojnë diçka tjetër, kjo mund të ndodhë veç në Kuvendin e Kosovës.

"Epoka e re": Disa deputetë të LDK-së dhe të LV-së nuk morën pjesë fare në votim për projektrezolutën e LDK-së. Cili është koment juaj për këtë?

Nitaj: Nuk më duket e rëndësishme kjo çështje. Ndoshta edhe ata e kishin kuptuar se do të dështonte rezoluta dhe kanë vendosur t'i kryenin punët personale. Dorën në zemër, nuk e kam kuptuar mungesën e Albin Kurtit, por edhe kjo është punë e tij.

"Epoka e re": Edhe një tentativë e koalicionit qeverisës për dialogun ka mbetur në proces. A do të provohet që sërish të nxirret në votim miratimi i delegacionit të Qeverisë për dialogun me Serbinë?

Nitaj: Besoj se nuk do të rreshtin përpjekjet për

konsensus por, sa i përket ekipit, unë nuk e kuptoj pse Qeveria kërkon votim në Kuvend. Ajo e ka mandatin ta caktojë ekipin vetë. Ajo duhet të ketë kujdes që marrëveshjen ta bëjë të atillë që t'i marrë dy të tretat e votave, se ekipi nuk është punë e Kuvendit. Platforma po.

"Epoka e re": Çfarë nëse nuk arrihet të gjendet një konsensus në mes të pozitës dhe opozitës për platformën e bisedimeve Kosovë - Serbi. Do të vazhdohet ky proces pa një konsensus të tillë?

Nitaj: Nëse nuk arrihet konsensusi, kam frikë se dikush tjetër do të vendosë për këtë çështje. Bota nuk po ka kohë të merret me hajgarexhi. Ne ka vite që nuk funksionojmë pa shtytjen e të tjerëve. Po duket se një pjesë e jona votojmë, qoftë edhe për interes të vendit, vetëm kur s'kemi qare. Qeveria e kryeministri janë

seriozë në këtë temë, por Kuvendi duhet ta marrë rolin e vet, nëse janë mirë në mend, por duket se dikush nuk është interesuar për këtë. Një pjesë e Kuvendit të vetmin interes e kanë për ta bërë sa më llugël!

"Epoka e re": Zgjedhjet e reja do të mund ta qartësonin situatën politike në vend?

Nitaj: Edhe 100 herë mund të mbajmë zgjedhje dhe situata do të mbetet po kjo që është. Nuk është bllokuar procesi për shkak të zgjedhjeve, por për shkak të vetëdijes që e kemi. Ne nuk mund të ndërrojmë brenda natës. Do t'i mbeteshim të njëjtit edhe pas zgjedhjeve. Bile edhe Hashim Thaçi, për të cilin po bëhet gjithë kjo lëmë, do të mbetet president. Kishte një shans që Kuvendi ta disiplinonte, por nuk e bëri. Inshallah po u kthehet mendja e humbur deputetëve dhe po e kuptojnë rëndësinë e këtij procesi.

Merkeli i përgjigjet letrës së Mustafës, shprehet e brengosur për ndryshimin e kufijve

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ia ka kthyer letrën kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, në të cilën ka inkurajuar vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe ka folur edhe për çështjen e liberalizimit të vizave. Me këtë letër kancelarja Merkel e ka falënderuar kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, për shkresën e datës 28 shtator të këtij viti, me të cilën e kishte njoftuar lidhur me qëndrimet e tij rreth dialogut në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Kancelarja Merkel ka theksuar se "edhe nga këndvështrimi im është shumë me rëndësi që Kosova ta vazhdojë dialogun me Serbinë me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian dhe ta shtyjë përpara normalizimin e marrëdhënieve. Debatin rreth ndryshimit të kufijve edhe unë, sikurse ju, po e përcjell me brengosje të madhe", ka porositur kancelarja Merkel. Duke trajtuar çështjen e liberalizimit të vizave të adresuar nga shkresa e kryetarit të LDK-

së, kancelarja gjermane Angela Merkel shkruan: "Unë jam e vetëdijshme sa e rëndësishme është arritja e udhëtimeve pa viza për qëllime turizmi për vendin tuaj. Thelbësore për Gjermaninë në këtë rast është plotësimi pa përjashtim i të gjitha kriterëve, para se mund të jepet liberalizimi i vizave. Konsultimet e shteteve anëtare të BE-së rreth kësaj çështjeje janë duke vazhduar". Kryetari i Lidhjes Demokratike

të Kosovës, Isa Mustafa, kishte njoftuar, në fund të muajit shtator të këtij viti, kancelaren gjermane Angela Merkel dhe ministrat e Punëve të Jashtme të të gjitha vendeve të BE-së lidhur me qëndrimet e LDK-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një refleksion në këtë letër kryetari Mustafa e pranoi para disa ditësh edhe nga ministri për Punë të Jashtme dhe Tregti të Hungarisë, Peter Szijarto.



opozita pa ndonjë arsye. "Opozita nuk ishte e interesuar të kishte pajtim për këtë çështje, sepse duket se ishte e interesuar të dështojë. Për LDK-në dhe LV-në më e rëndësishme ishte forma sesa përmbajtja. Ata e kishin një propozim që rezoluta të plotësohej edhe me pika të shumicës, që ishin shumë korrekte, të plota dhe të favorshme, por pashp-

Kirurgjia Maksillofaciale e QKUK-së, numër rekord të operacioneve

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale në QKUK ka arritur ta rrisë dukshëm numrin e operacioneve dhe shërbimeve që ofrohen për pacientë. Shtimi i vëllimit të punës në këtë klinikë ka bërë që gjatë muajit tetor të ketë numër rekord të pacientëve të operuar deri më tani. "Sipas statistikave nga kjo klinikë, në muajin tetor ka pasur 152 operacione, e që paraqet numrin më të madh të operacioneve të realizuara gjatë një muaji. Kjo punë është arritur nga ekipi i mjekëve nga kjo klinikë e me përkrahje edhe nga anesteziologët e Klinikës së Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv", është thënë në komunikatën e QKUK-së. Në komunikatë thuhet se si rezultat i punës së palodhshme të klinikës, momentalisht nuk

ka listë të pacientëve që janë në pritje. "Kjo klinikë trajton lëndimet e kockave dhe indeve të buta (aksidentet e komunikacionit, rrëzimet dhe lëndimet aksidentale, infeksionet, tumoret beninje dhe malinje të lëkurës, të kockave, indeve të buta të sistemit orofacial). Po ashtu, ofrohet kirurgjia paraprozetikore, deformimet e lindura dhe të fituara të fytyrës dhe nofullave, buzës dhe qiellzës së çarë, sëmundjeve të gjëndrave të pështymës dhe kirurgjisë estetike të fytyrës, ku veçanërisht duhet të veçohet kirurgjia ortognatike", theksohet në komunikatën e QKUK-së.

Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale është themeluar më 21 mars të vitit 1983 dhe konsiderohet si klinika e vetme që ofron shërbim specialistik brenda 24 orëve në Kosovë. "Ambulanca specialiste funk-



sionon në kuadër të klinikës dhe arrin t'i trajtojë 10 000 pacientë gjatë vitit. Në klinikë

ndodhen 32 shtretër ku gjatë vitit përafërsisht hospitalizohen 700 pacientë. Operohen rreth 1100

raste me anestezi lokal apo të përgjithshëm", thuhet më tutje në komunikatën e QKUK-së.

Pas propozimit të ministrit Gashi, Kuvendi ka miratuar një sërë ligjesh



PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Në seancën e së premtes të Kuvendit të Kosovës, deputetët kanë miratuar në lexim të parë projektligjet: Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-090 për

Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 Ligji i Sportit dhe Ligji Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka falënderuar deputetët që votuan pro miratimit të këtyre ligjeve që janë në interes për fushat që kanë përgjegjësi MKRS-ja.

Gjithashtu, ministri Gashi ka falënderuar edhe të gjithë ata që kanë kontribuar për përgatitjen e projektligjeve në fjalë. "Hartimi dhe zbatimi efektiv i legjislacionit përkatës mbetet prioritet i rëndësishëm. Së këndejmi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes projektligjeve të sipërshtuara ka bërë harmonizimin e dispozitave përkatëse. Prandaj, kalimi i propozimeve të MKRS-së nga ana e Kuvendit plotëson objektivat strategjike të ministrisë, edhe kompletton harmonizimin e këtyre projektligjeve me ligjet e tjera të Kosovës", është shprehur ministri Gashi.

Shefi i asamblistëve të LV-së në Ferizaj i bashkohet Nismës Socialdemokrate

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Shefi i Asamblistëve i Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin Komunal të Ferizajt, Ali Halimi, të premten i është bashkuar Nismës Socialdemokrate. Bashkë me Halimin nga Vetëvendosje te Nisma Socialdemokrate kanë aderuar edhe disa anëtarë të tjerë të partisë së Albin Kurtit.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u ka uruar mirëseardhje anëtarëve të rinj. Nisma në Ferizaj, sipas Limajt, do të jetë shumë më e fuqishme. "Sot është një ditë e rëndësishme për Nismën. Nga sot

pjesë e familjes sonë politike do të bëhet shefi i asamblistëve të LV-së në Ferizaj, Ali Halimi, me bashkëpunëtorë. Nisma në Ferizaj do të jetë shumë më e fuqishme. I urojmë mirëseardhje asamblistit për t'i ofruar bashkëpunimin e përbashkët të Nismës në Ferizaj dhe Kosovë", ka thënë Limaj.

Ndërkaq Ali Halimi ka thënë se ka kënaqësinë që i është bashkuar Nismës. Ai është zotuar se do të angazhohet që idetë socialdemokrate t'i forcojnë në Ferizaj dhe Kosovë. Nismës të premten i janë bashkuar edhe



Bekim Ademi, Rexhep Ramadani, Enver Ismajli, Isadora Zeqiri,

Mevludin Ibishi dhe Flamur Sallahu, të gjithë ish-anëtarë të

Vetëvendosjes në Komunën e Ferizajt.

Në 29-vjetorin e rënies heroike, kujtohen Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, figura të ndritura të qëndresës kombëtare

Përfaqësues të pushtetit qendror dhe lokal të premtën kanë bërë homazhe dhe vizitë në familjet Zhitia dhe Fazliu, në 29-vjetorin e rënies heroike të Afrimit dhe Fahriut. Në këtë përvjetor Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu janë vlerësuar figura të ndritura të qëndresës dhe sakrificës sonë kombëtare



komandantin e stacionit policor, ekzekutivin dhe qytetarët e shumtë, nderuam jetën dhe veprën e heroit Fahri Fazliu", ka thënë kryetari Gashi.

Kosovës, Afrim Zhitinë dhe Fahri Fazliun, ndër figurat më të ndritura të qëndresës dhe sakrificës sonë kombëtare. Pararendës të zhvillimeve vendimtare në lëvizjen dhe përpjekjet për çlirim, vepra e Afrimit dhe Fahriut qëndron e përjetësuar në thelbin e lirisë dhe shtetit të Kosovës. Lavdi!", ka thënë Haradinaj. Edhe kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, në fshatin Llugë të Besianës ka bërë homazhe te varri i heroit Afrim Zhitia, si dhe në fshatin Llaushë po të kësaj komune ka bërë homazhe edhe te varri i heroit Fahri Fazliu. "Për të vazhduar më pas në komunën time në Obiliq, pranë lapidarit të heroit Fahri Fazliu, ku së bashku me kryesuesin e Kuvendit Komunal,

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu përjetësohen në pullat postare të Kosovës

Nga dita e premte figura e Afrim Zhitisë dhe e Fahri Fazliut janë përjetësuar në pullat postare të Republikës së Kosovës për lirinë e së cilës e dhanë jetën. Sejdi Hoxha, kryeshef ekzekutiv i Postës së Kosovës, duke bërë prezantimin e pullës postare me portretet e heronjve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, ka thënë se ndihet krenar që Posta e Kosovës lëshon në qarkullim pullën postare që u dedikohet heronjve të kombit.

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar dëshmorët e kombit Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia me rastin e 29-vjetorit të rënies së tyre. Haradinaj, pas homazheve që ka bërë të premtën te vendi i rënies së Fahri Fazliut dhe Afrim Zhitisë në Bregun e Diellit në Prishtinë, ka vizituar edhe familjet e dy dëshmorëve. Me këtë rast, ai ka thënë se Fahri Fazliu e Afrim Zhitia janë ndër figurat më të ndritura të qëndresës kombëtare. "Homazhe dhe vizitë në familjet Fazliu dhe Zhitia, në 29-vjetorin e rënies heroike të Fahriut dhe Afrimit. Sot me nderim i kujtojmë heronjtë e



KDI-ja i prezanton KQZ-së dizajnet e reja të fletëvotimeve

Prishtinë, 2 nëntor (ER) - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, i ka dorëzuar zyrtarisht kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së), Valdete Dakës, dizajnet e reja të fletëvotimeve të cilat janë përgatitur në kuadër të projektit "Çdo votë vlen". Kryeziu ka thënë se i është dorëzuar KQZ-së edhe raporti përmbledhës "Çdo votë duhet të vlejë!" i cili përmban rezultatet e testimit fizik të fletëvotimit me 1 200 qytetarë. Sipas tij, kryetarja Daka ka vlerësuar pozitivisht këto fletëvotime dhe ka shprehur vullnetin që ato të merren parasysh gjatë miratimit të diza-



jneve të reja të fletëvotimeve nga ana e KQZ-së.

Ramadani: Tranzicioni i FSK-së thellon partneritetin në siguri dhe mbrojtje

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, në përmbyllje të aktiviteteve të konferencës "FSK-ja dhe partnerët 2018/2", ka theksuar se tranzicioni i FSK-së thellon partneritetin në siguri dhe mbrojtje. Në një konferencë ka shprehur vlerësimin për arritjet e bëra të FSK-së, sidomos në angazhimet bilaterale, por edhe multilaterale me shtetet partnere. "Tranzicioni i FSK-së, si proces legjitim dhe gradual, e bën Kosovën partnere të plotë me shtetet veç e veç dhe me NATO-n", ka thënë zëvendësministri Ramadani. Në ditën e



parë të kësaj konference kanë folur edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Ata kanë bërë me dije se tranzicioni i Forcës së

Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri është proces i pandalshëm, i domosdoshëm dhe në interes të të gjithëve në Kosovë dhe në rajon.

Deputetët dyshojnë se Vetëvendosja organizoi 'tollovinë' për punësime në Gjermani

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Milaim Zeka, kanë ngrehur dyshime se organizimi për punësim në Gjermani, që ndodhi ditë më parë në Prizren, është i organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje!, me qëllim të mosliberalizimit të vizave. Fillimisht ishte deputetja e PDK-

së, Luljeta Veselaj-Gutaj, e cila e ngriti çështjen e kompanisë gjermane që ofronte mundësi punësimi në Prizren. "Disi pa paragjykuar konsideroj se ishte një zhvillim aspak normal e më së paku i duhur për rrethanat në të cilat po kalojmë si shtet, por përtej kësaj shoh edhe qëllime të caktuara në këtë ngjarje. Dua të di nga udhëheqësit e nivelit qendror dhe nivelit lokal, a janë në dijeni për një organizim të tillë në

çfarë cilësie është organizuar një mobilizim i tillë për punë jashtë vendit, a kanë leje këta persona apo kjo kompani, a duhen organet shtetërore ta analizojnë cilësinë e organizime të tilla duke pasur parasysh se këto organizime e sfidojnë në tërësi edhe aparatit shtetëror të vendit", ka thënë Veselaj-Gutaj. Edhe deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka thënë se kanë fakte që njerëzit

e Lëvizjes Vetëvendosje janë duke i organizuar këto gjëra në Prizren. "Ka fakte dhe na kanë ardhur informacione që njerëzit e Lëvizjes Vetëvendosje po i organizojnë këto gjëra në Prizren dhe ata duhet ta marrin përgjegjësinë, janë këta njerëz që duan ta ulin në zero imazhin e Kosovës para ndërkombëtarëve për mosliberalizimin e vizave, sepse këta jetojnë vetëm në skandale, kaos dhe turbullira. Lëvizja

Vetëvendosje jeton vetëm kur qytetarët i nxit për gjëra që nuk kanë të bëjnë me realitetin. Mbi bazën e kësaj dola për të thënë se ka informacione dhe është shumë mirë që Policia e Kosovës dhe hetuesit e prokurorët po merren me ngjarjet në Prizren mbrapa të cilave ka dyshime se janë njerëzit e Lëvizjes Vetëvendosje", ka deklaruar deputeti Zeka në seancën e së premtes të Kuvendit të Kosovës.



Zëvendësguvernatori i BQK-së, pjesë e konferencës vjetore të bankës së Shqipërisë

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Sokol Havolli, po merr pjesë në konferencën vjetore të organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Shkolla Ekonomike dhe e Shkencave Politike të Londrës (London School of Economics and Political Science) me temë "Politika monetare, integrimi ekonomik dhe normaliteti i ri". Në fjalën e tij para të pranishmëve, zëvendësguvernatori Havolli ka prezantuar zhvillimet aktuale në sistemin financiar të Kosovës në përgjithësi, në veçanti zhvillimet në sistemin bankar, të cilat po karakterizohen me qëndrueshmëri të lartë, rritje të financimit për ekonominë e vendit dhe përmirësim të kushteve për qasje në financa. Me këtë rast, zëvendësguvernatori Havolli elaboroi mbi rrugën që ka ndjekur BQK-ja për të ndërtuar një sistem financiar bashkëkohor, stabil



dhe me rritje të vazhdueshme, si dhe mbi angazhimet shumëdimensionale që po bën për ta mbështetur zhvillimin e mëtejshëm dhe të qëndrueshëm të këtij sektori, si dhe rritjen e

mëtejshme të rolit të tij në funksion të mbështetjes së zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit. Zëvendësguvernatori Havolli ka theksuar nevojën për rritje

të mëtutjeshme të bashkëpunimit ndërmjet bankave qendrore dhe autoriteteve rregullative financiare ndërkombëtare si mënyrë për avancimin e përbashkët të

kapaciteteve të nevojshme për t'i përballuar në mënyrë sa më efektive sfidat rreth ruajtjes së stabilitetit financiar. Kjo konferencë vjetore është organizuar në katër sesione.



Bashkimi doganor dhe policor Shqipëri - Kosovë së shpejti do të bëhet realitet

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në vizitën e tij në pikën kufitare të Morinës në Kukës, ka bërë me dije se së shpejti do të bëhet realitet bashkimi doganor Shqipëri - Kosovë. "Bashkimi i shërbimeve doganore e policore të Shqipërisë e Kosovës, së shpejti do të bëhet realitet", ka thënë kryeministri Rama

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Pika e kalimit kufitar të Morinës nisi me vënie në funksionim të ambienteve të reja tërësisht të transformuara sipas standardeve evropiane. Ky investim në infrastrukturë dhe teknologji është financim i qeverisë shqiptare dhe Bashkimin Evropian dhe i paraprinë pikës së përbashkët kufitare dhe doganore mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Kryeministri Edi Rama vizitoi ndërtesën e rikonstruktuar, funksionimi i së cilës ka përshpejtuar proceset, duke bërë që lëvizja e njerëzve dhe e mallrave në këtë pikë të jetë më e shpejtë dhe më e lehtë. Rama ka bërë me dije se së shpejti do të bëhet realitet bashkimi doganor Shqipëri - Kosovë. "Bashkimi i shërbimeve doganore e policore të Shqipërisë e Kosovës, së shpejti do të bëhet realitet", ka thënë kryeministri Rama. Ai ka vlerësuar finalizimin e përpjekjeve

për pikën e përbashkët doganore e cila do të jetë me përfitim të ndërsjellë për qytetarët e Shqipërisë dhe Kosovës. "Me rëndësi është që, ne, pas kaq shumë kohësh po finalizojmë këtë pikë të përbashkët, që të mos ketë më dy palë kontrolle, dy palë polici etj., por të jetë një pikë me kontroll të shpejtë, të unifikuar të dy përfaqësive doganore dhe policore të dy shteteve dhe kufiri të fillojë të bëhet shumë fluid, shumë i lehtë për të gjithë, sepse në ato volume me miliona e miliona, është një superngarkesë që të gjitha bëhen nga dy herë dhe të gjitha llojet e kontrolleve të jenë nga të dyja palët. Ky është një hap shumë i rëndësishëm përpara, para se ta kemi edhe implementimin e bashkimit doganor që, me sa duket, jemi afër tani, që na e bën fluid kufirin këtu", ka deklaruar

Rama. Ndërkaq ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, ka thënë se me përfundimin e projektit, për të cilin do të vazhdojë puna edhe në vitin e ardhshëm, do të mundësohet një nga pikat më të mira qoftë në aspektin kufitar të policisë, qoftë në aspektin e tregtisë. "Ky është investim i IPA-s në godinë dhe i paraprinë pikës së përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës, qoftë për pjesën e Policisë, qoftë doganës që ne besojmë do ta materializojmë në dy tre muajt e ardhshëm. Ndërkohë që, me doganën fillojmë në 2019-n gjithë investimin për zgjerimin e parkimit. Parkimi sot është shumë i vogël dhe ka krijuar të metë serioze në logjistikë. Në vitin 2019 do ta heqim atë problematikë dhe besoj kjo do të jetë një nga pikat më të mira

kufitare", ka thënë Ahmetaj. Operimi në një pikë të përbashkët do ta lehtësojë së tepërmi lëvizjen, pasi mjetet do të procesohen në një pikë të vetme, që do të thotë, më thjesht një ndalesë, një kontroll. Zëvendësministria e Brendshme, Rovena Voda, ka shpjeguar për mënyrën e funksionimit të pikës së përbashkët. "Godina do të jetë e përbashkët. Këtu do të vendoset policia kufitare e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës dhe nga ana tjetër kemi doganën e Shqipërisë dhe të Kosovës. Besoj se kjo do të ndihmojë edhe faktin se ne po përgatisim pikën e përbashkët kufitare dhe do të ketë kontrolle të përbashkëta, patrullime të përbashkëta. Në fakt, një përvojë të mirë e kemi. Vetëm gjatë 9-mujorit të parë janë bërë 50 patrullime të përbashkëta me policinë kufitare të Kosovës", ka thënë Voda.


ATK-ja grumbulloi 391.6 milionë euro

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) po vazhdon performancën në bazë të zotimeve të cilat i ka përcaktuar për këtë vit, si dhe në përputhje me pro-

jeksionet e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës. Deri më 30 shtator të këtij viti ATK-ja ka grumbulluar 75.5 për qind të të hyrave të përgjithshme vjetore apo, shprehur në shifra, 336.6

milionë euro. "Se kemi një nivel shumë të mirë sa i përket realizimit të planit të të hyrave këtë e tregon edhe krahasimi në mes të periudhave, nëse e krahasojmë periudhën janar-shtator 2018

me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje për 32.8 milionë euro, ndërsa më shumë se plani kemi 9.6 milionë euro apo 2.9 për qind", është thënë në njoftimin e ATK-së.



Nis ndërtimi i 117 serrave për fermer të Komunës së Rahovecit

Rahovec, 2 nëntor (ER) - Në Rahovec ka nisur projekti për ndërtimin e 117 serrave për fermerë të cilët janë përfitues. Fillimin e punimeve në këtë projekt të rëndësishëm për fermerët e ka parë edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, i cili ishte i shoqëruar nga nënkryetari Fatmir Iska, Rumir Zhuniqi, drejtor i DUPMM-së dhe Berat Duraku, drejtor i DBPZHR-së. "Jemi të përkushtuar të jemi

pranë bujkut dhe ky është vetëm një nga projektet që e dëshmon një gjë të tillë", ka thënë kryetari Latifi. Ai ka bërë me dije se ky është viti i parë që është rritur sipërfaqja, pasi ka serra 1.5, 3 dhe 5 ari, ndërsa participimi nga fermerët do të jetë 20 për qind e jo 25 për qind sikur ka qenë në të kaluarën. Me kontratën që është lidhur do të ndërtohen serra në sipërfaqe 3.5 ha në Komunën e Rahovecit.



Hapet ekspozita 'Antikiteti i qytetit të Rahovecit'

RAHOVEC, 2 NËNTOR (ER) - Në muzeun e qytetit në Rahovec është hapur ekspozita "Antikiteti i qytetit të Rahovecit" nga autori Sheqajdin Durguti. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe Bjondina Kleqka, drejtore-shë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Avni Morina, drej-

tor i Drejtorisë Komunale të Arsimit. "Jam e nderuar që marr pjesë në ekspozitën me temë 'Antikiteti i qytetit të Rahovecit' nga autori Sheqajdin Durguti. DKRS-ja do të vazhdojë të përkrahë aktivitete të tilla, posaçërisht kur është fokus promovimi i traditës dhe

kulturës shumëvjeçare të Komunës së Rahovecit", ka thënë drejtoresha Kleqka. Po ashtu, ajo ka theksuar se ekspozita do të vazhdojë të mbetet e hapur edhe në ditët e ardhshme dhe ka ftuar gjithë të interesuarit ta vizitojnë muzeun e qytetit dhe të njihen me pasuritë antike.



Vihet gurthemeli i shkollës së mesme profesionale në Komoran

DRENAS, 2 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar dhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të premtën kanë vënë gurthemelin e shkollës së mesme profesionale në Komoran të Drenasit. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka thënë se fillimi i ndërtimit të kësaj shkolle është një ngjarje e veçantë për Komoranin dhe rrethinën, veç të tjerash edhe për faktin se Ministria ka vënë prioritet zhvillimin e arsimit

dhe aftësisimit profesional në Kosovë. Bytyqi ka thënë se investimi nga MASHT-i dhe mbikëqyrja nga Ministria e Administratës Publike si dhe sigurimi i lokacionit nga ana e Komunës së Drenasit për ndërtimin e kësaj shkolle është dëshmi e përkushtimit tonë që të sigurojmë kushte për një arsim cilësor. Ministri Bytyqi ka thënë se në bashkëpunim me Komunën e Drenasit do të bashkërendohen veprimet, në mënyrë që të sigurohen informatat e nevo-

jshme për nevojat e tregut të punës dhe mbi bazën e nevojave të bizneseve të kemi profile që të rinjtë tanë të moshës 18-vjeçare të jenë të gatshëm për tregun e punës. "Kjo shkollë do të ketë një bashkëpunim të ngushtë me bizneset ku nxënësit do të kenë mundësinë e zhvillimit të anës praktike të të mësuarit", ka thënë ministri Bytyqi. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm deputetë të Kuvendit të Kosovës, zëvendësministra dhe përfaqësues të Komunës së Drenasit.

Hapet zyra e policisë në stacionin e autobusëve në Gjilan

Gjilan, 2 nëntor (ER) - Në ndërmarrjen komunale "Stacioni i Autobusëve" në Gjilan është bërë hapja e zyrës për praninë e policisë, me qëllim të rritjes së sigurisë publike, kujdesit ndaj udhëtarëve dhe operatorëve. I pari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka apeluar te të gjithë operatorët që të jenë vigjilentë dhe ta zbatojnë ligjin dhe rregullat e komunikacionit. Haziri ka konfirmuar se në ndërmarrjen publike "Stacioni i Autobusëve" do të vazhdojnë investimet. Ai tha se pret certi-

fikimin e stacionit sipas udhëzimeve ligjore. "Investimet kanë të bëjnë me infrastrukturën e terrenit dhe objektit në mënyrë që të gjitha llojet e transporteve që kërkohen të jenë të koordinuara edhe me stacionet e tjera. Gjithashtu, PK-ja do t'i ndërmarrë masat e nevojshme dhe nuk do të ketë as ndalje të paautorizuar në territorin e Komunës së Gjilanit, në mënyrë që stacioni të jetë në funksion të mbarëvajtjes së detyrave të veta ligjore që ka", ka thënë Haziri.



Shtatë aktakuza për rastet e dhunës në familje në Gjakovë

Gjakovë, 2 nëntor (ER) - Prokuroria Themelore e Gjakovës ka njoftuar se gjatë muajit tetor ka ngrit-

ur shtatë aktakuza për rastet e dhunës në familje. Sipas kësaj prokurorie, për të gjitha rastet është

marrë aktvendim për fillim të hetimeve dhe është caktuar paraburgimi i katër të pandehurve dhe

një arrest shtëpiak, ndërkaq ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura hetimore.



Sulm me thikë në Londër, dy persona të plagosur

LONDËR, 2 NËNTOR - Policia në Britani ka thënë se dy persona janë therur me thikë të premtën në një incident në qendër të Londrës, derisa zyrtarët e armatosur kanë shkuar në skenën ku ka ndodhur incidenti, përkatësisht në selinë e Sony

Music në Kensington, transmeton Reuters.

Policia e Londrës ka thënë se ata kanë arrestuar një person, dhe se sulmi nuk është duke u trajtuar si terrorist.

"Zyrtarët, duke përfshirë zyrtarët të armatosur dhe shërbimet e

ambulancës janë duke ofruar ndihmë", ka thënë policia.

"Evakuimi është duke ndodhur vetëm si masë parandaluese. Dy persona janë therur me thikë dhe po presim që të kuptojmë gjendjen e tyre", kanë shtuar zyrtarët policorë.



Ballkani dhe hija e Luftës së Parë Botërore

John Lampe, njohës i zhvillimeve ballkanike, thotë se njësitë e reja që u krijuan në Ballkan, rezultante të marrëveshjeve arbitrare mes fuqive botërore, me popullsitë e përziera etnike dhe pretendimet për zgjerim territorial u bënë burim abuzimesh, masakrash, përndjekjesh të ndërsjella mes kombeve ballkanike



PARIS, 2 NËNTOR - Më 11 nëntor udhëheqës botërorë do të mbledhen në Paris për të kujtuar 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, një ndër konfliktet më të përgjakshme që ka njohur njerëzimi dhe që la gjurmë të thella në pejsazhin geopolitik të globit për dekada me radhë.

Kanë kaluar 100 vjet që nga përfundimi i Luftës I Botërore, por gjurmët e saj kanë vazhduar të ndjehen në botë për thuajse një shekull. Kaosi dhe shkatërrimi i pas-konfliktit krijuan terren për ideologji të ekstremit që diktuan zhvillimet politike në një pjesë të madhe të globit për dekada me radhë.

"Pa Luftën e Parë Botërore vështirë të imagjinohet një lëvizje radikale revolucionare si ajo e Leninit që mori pushtetin në Rusi, e që u bë faktor kyç në përhapjen e ideologjisë komuniste si alternativë funksionale. Dhe në skajin tjetër të spektrit - nazizmi dhe fashizmi, vështirë të imagjinohet që këto ideologji të skajshme do të bëheshin faktorë qendrorë në Evropë dhe në historinë globale, pa Luftën e Parë Botërore", thotë Aviel Roshwald, profesor i historisë në Universitetin "Georgetown" në Uashington.

Lufta I Botërore la pas perandori të shpërbëra, ekonomi të

shkatërruara, miliona të vrarë, të plagosur e të zhvendosur që u bënë burim i radikalizimit të shoqërive të prekura nga konflikti, shpjegon historiani Aviel Roshwald.

"Menjëherë pas luftës, në 1918-1919 u duk sikur ithtarët e idealit të vetëvendosjes për kombet e vogla të Evropës dolën fitimtarë, pasi perandoritë shumetnike si Perandoria Austriake, Romanovët në Rusi, Perandoria Osmane në Lindjen e Mesme u shpërbënë dhe u lanë vend shteteve të reja. Por secili nga këto shtete i dalë nga hiri i perandorive të shpërbëra lindi në kaos, në sisteme ekonomike të ndërprera, nga shkatërrimi i luftës", tha Roshwald.

John Lampe, njohës i zhvillimeve ballkanike, thotë se njësitë e reja që u krijuan në Ballkan, rezultante të marrëveshjeve arbitrare mes fuqive botërore, me popullsitë e përziera etnike dhe pretendimet për zgjerim territorial u bënë burim abuzimesh, masakrash, përndjekjesh të ndërsjella mes kombeve ballkanike. Jehona e atyre ditëve ndjehet ende sot në zhvillimet politike në rajon.

"Këto kujtime nga koha e luftës, ky sfond i asaj periudhe ndihmon për të kuptuar sa e vështirë është tani të gjendet një zgjidhje për kufirin mes Serbisë dhe Kosovës", tha ai.

Ideali që prezantoi Lufta e Parë Botërore - e drejta e kombeve për vetëvendosje - është përfolur e analizuar shumë në 100 vjetët e fundit. Profesor Lampe thotë se vetëvendosja në praktikë nuk ofron gjithmonë zgjidhje të qëndrueshme të pretendimeve territoriale.

"Nëse me vetëvendosje nënkuptojmë një qeveri kushtetuese që u ofron të gjithë qytetarëve një shans për votë, dakord. Por nëse me këtë shprehje nënkuptojmë vetëvendosje vetëm për një grup etnik, është e qartë që nuk shërben për zgjidhje të suksesshme", tha Lampe.

Profesor Roshwald thotë se historia e njerëzimit ka dëshmuar se kur vetëvendosja rezulton në ndryshim kufijsh, dalin më shumë probleme të reja se sa zgjidhen. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë, thotë ai, zgjidhja e vetme funksionale mund të gjendet të marrëveshja mes palëve.

"Në shumë raste, ndryshimi i kufijve krijon burime të reja për hakmarrje dhe pretendime irredentiste vite më pas. Me rëndësi kyçe për Kosovën dhe Serbinë është gjetja e një zgjidhjeje që pranohet nga të dyja palët dhe jo që imponohet nga njëra palë", tha Roshwald.

Profesor Lampe thotë se problemi nuk qëndron te kufiri aktual mes Kosovës dhe Serbisë, por te gjurmët që ka lënë historia te këto popullata, te një mëri që mbartin dy kombet brenda vetes, të ushqyer në masë të madhe nga zhvillimet gjatë dhe pas Luftës I Botërore. Por ai sjell shembullin e Irlandës, për të dëshmuar se ka zgjidhje edhe për problemet e armiqësive të gjata mes popullatave, pa nevojën e ndryshimit të kufijve.

"Kërkohet një angazhim nga një numër kritik udhëheqësish si nga serbët ashtu edhe shqiptarët në Kosovë që të mbështesin një

marrëveshje për t'i garantuar pjesëmarrje pakicës serbe. Edhe vetë pakica serbe duhet ta kuptojë se është në interesin e tyre të angazhohet, të marrë pjesë në parlamentin e Kosovës", tha ai. Perëndimi punoi shumë për të nxjerrë mësim nga dy luftërat botërore dhe për të vënë në funksionim garanci që konflikte të tilla shkatërrimtare nuk do të përsëriteshin, duke krijuar institucione transatlantike, pista shkëmbimesh për të rritur besimin e ndërsjellë dhe për të lehtësuar dialogun.

Fuqitë perëndimore, dikur armike në anë të kundërta të konfliktit, përqaftuan parimet e tolerancës, shtetit ligjor, kompromisit, të drejtat e komuniteteve, të gjitha të frymëzuara nga mësimet e nxjerra nga konfliktet, mësimet që Ballkani duket se nuk i ka përvetësuar ende 100 vjet pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

ShBA-ja rivendos sanksionet kundër Iranit

WASHINGTON, 2 NËNTOR - Administrata e presidentit Donald Trump njoftoi të premtën rivendosjen e të gjitha sanksioneve të Shteteve të Bashkuara mbi Iranin, të cilat ishin hequr nën marrëveshjen bërthamore të vitit 2015.

Sanksionet do të hyjnë në fuqi të hënën dhe mbulojnë sektorë si transporti, sektori financiar

dhe ai energjetik i Iranit. Ky është grupi i dytë i sanksioneve që administrata rivendos që kur presidenti Donald Trump u tërhoq nga marrëveshja historike në muajin maj.

Me përjashtime të kufizuara, sanksionet do të penalizojnë ato vende të cilat nuk ndalojnë importimin e naftës iraniane dhe kompanitë e huaja që

bëjnë biznes me njësi iraniane që ndodhen në listën e zezë, përfshirë bankën qendrore të Iranit, një numër institucionesh financiare private si dhe portin e kompanitë e transportit nën menaxhimin qeveritar.

Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo tha se sanksionet "synojnë të ndryshojnë rrënjë-

sisht sjelljen e Republikës Islamike të Iranit". Ai publikoi një listë me 12 kërkesa që Irani duhet t'i plotësojë nëse dëshiron heqjen e sanksioneve. Ato përfshijnë dhënien fund të mbështetjes për terrorizmin, dhënien fund të angazhimit ushtarak në Siri si dhe ndalimin e plotë të prodhimit të raketave bërthamore dhe balistike.



Botime me rastin e 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut

Prof. Dr. Eqrem Zenelaj, veprat e tij një Akademi në vete

Albumi historik kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" botim me vlera të veçanta. Argumente nga njëzet arkivat e njohura të Europës në mbi dymijë dokument, portrete, gravura. 50 mirënjohje nga Arkivat e Institucionet vendesh të ndryshme. Çuditërisht nuk e hasa emrin Prof. Dr. Eqrem Zenelaj në Akademitë Kombëtare Shqiptare. Apo, njeriu ynë që hulumton jashtë vendit vlerësohet vetëm nga të tjerët!



Nga Hazir MEHMETI,
Vjenë

- Vjena dje mburrej me figurat e njohura në historinë e kulturën shqiptare, si Norbert Jokli, Franz Nospa Eqrem Çabej, Lasgush Poradeci, Asdreni, Dr. Gjergj Pekmezi, Krist Maliki, Dr. Sokrat Dodbibaj, Qemal Butkën, e disa tjerë, kurse sot mburret me veprën e Prof. Dr. Eqrem Zenelajt, i cilësuar si njëri ndër hulumtuesit më të mirë shqiptar i tanishëm. Ai sërish vjen me botimin e veprës së tij të dhjetë, albumin historik kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Kjo vepër botohet me rastin e "Vitet Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në 550 vjetorin e vdekjes së kryeheroit, i shpallur nga të dy shtetet: Shqipëria dhe Kosova. Ky sihariq vjen pas "Pellazgët - Ilirët - Shqiptarët" e cila ishte më e kërkuara nga gjithë botimet e vitit 2017. Vetëm ata që kanë lexuar prej Prof. Dr. Eqrem Zenelajt, mund të kanë afërsisht të njohur një figurë kaq me vlera në fushën e historisë e diplomacisë kombëtare dhe më shumë. Jeta e tij, lirisht mund të thuhet, është jetë e terë arkivave, bibliotekave me emër në botë: Vjenë, Vatikan, Romë, Frankfurt, Berlin, Paris, Londër etj. Ai nuk kurseu asgjë nga vetja e tij, familja e tij, shoqëria e fafesisë i tij në rrugën e realizimit të misionit të tij me rëndësi kombëtare. Gjurmëve të jetës së tij, duket se frymëzimi i tij ka burim të thellë kombëtar që nga baladat dhe këngët kreshnike të recituara dhe kënduara nga vet ai që në moshë të re. Dhe, s'ka se si të mos të kujton Homerin e lashtë që i këndonte jetës, trimërisë e lavdisë në kohë të kolosëve pellazgë të lakmuar e grabitur aq pamëshirshëm nga të tjerët. "Po i bjen era retë e zeza", zëri i tij i freskët rinor në

këngë thërret në vigilençë me pendë e vepër për ta mbrojtur e prosperuar historinë e kulturën kombëtare gjeneratave. Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeu, ishte një inspirim shtesë në realizimin e një rruge të gjatë hulumtuese shumëvjeçare arkivore mbi fakte të pakontestueshme rreth jetës dhe veprës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Prof. Dr. Eqrem Zenelaj zbuloi dokumente të shkruara, gravura e portrete, partitura të punuara nga mjeshtrit më të njohur të kohës duke ua ofruar publikut dhe shkencës si fakte të reja rreth jetës dhe veprës së heroit kombëtar të cilat nuk ishin të ditura më parë. Nga këto materiale botoi veprën e re "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në shqip dhe në anglisht, në "Artini", Prishtinë, me redaktor Jahir Ahmetin. Autori me respektin e krenarinë ndaj prindërve të tij, Musliut dhe Hajrijes, hap faqet e librit të tij të mrekullueshëm.

Libri fillimisht u promovua në Bibliotekën Kombëtare të

Kosovës, ku mes tjerash rreth tij për RTK-në, folen autori dhe Prof. Dr. Muhamet Malaj. Prof. Malaj mes tjerash tha: "Në fakt e veçanta e këtij albumi qëndron në mbështetjen burimore për arsye se portretet, gravurat rrjedhin nga bibliotekat, arkivat e Evropës dhe përmban vlera artistike dhe historiografike. E veçanta tjetër është ana tekstuale ku paraqitet kronologjia e historisë së Skënderbeut që nga lindja, pastaj pema gjeonealogjike, origjina e tij deri në vdekje. Në fakt albumi përmban një lloj libri atraktiv i cili shoqëron anën tekstuale me anën vizuale. Skënderbeu me kohë i ka kaluar kufijtë kombëtare ai është pjesë e trashëgimisë historike të Europës, pse jo dhe i botës. Duhet larguar disa shabllone të krijuara në formë të pavetëdijshme janë krijuar për Skënderbeun; duke e portretizuar atë vetëm si një luftëtar me shpatë duke e kundërshtuar perandorinë osmane për një çerek shekulli, në fakt, ashtu siç paraqitet edhe në albumin historik, figura e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, nuk ishte vetë e luftëtarit por shumë më komplekse. Para së gjithash ai ishte një burrështetasi, ishte themelues i shtetit shqiptar. Ne, si shqiptar, çdo herë historiografia qëllimkeq, na ka goditur në kontekstin se

shqiptarët; ditën me luftuar, por nuk ditën me krijuar shtetin. Prandaj, bazuar në argumente se kjo ide e perceptuar për Skënderbeun vetëm si luftëtar duhet të jetë e dorës së dytë, për arsye se Skënderbeu ishte para se gjithash një burrë shtetasi. Ai ishte një intelektual i kohës së vet, ishte një poliglot që njihnte shqipen, italishten sllavishten, turqishten, persishten, e merita kryesori ishte formimin i shtetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në rrethanat e luftës. Pjesa e gjeonealogjisë është shumë faktike dhe vërteton origjinë e pastër shqiptare të Skënderbeut bazuar në burimet arkivore të shumtë faktik. Pra, ky libër është qëlluar, në kohën e qëlluar" Autori i librit Prof. Dr. Eqrem Zenelaj në fjalën e tij mes tjerash shtoi: "Për Gjergj Kastriotin Skënderbeun kanë folur shumë autorë botëror. Kam hasur në rreth pesë mijë dokumente rreth tij në njëzet arkiva të Europës. Ky është një album historik kombëtar i cili i dedikohet Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeu, 550 vjetori i vdekjes së tij. Jam përpjekur për njëzet vite të tuboj portrete, dokumente, gravura të ndryshme për Gjergj Kastriotin Skënderbeun dhe pas asaj ia kam arritur që ky album i mrekullueshëm të del për heron tonë kombëtar, për figurën emblematike dhe figurën më

E treta është se ky album është punuar në dy gjuhë: në shqip dhe anglisht të cilin e kam shpërndarë në të gjitha arkivat e Europës, kam qenë i obliguar dhe kam marr rreth 50 mirënjohje nga arkivat apo diplomaci të Evropës.

Dhe, tjetra është viti i lindjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut i cili është kontradiktor të shumë autorë dhe duke analizuar rreth dy-tre mijë dokumente për Skënderbeun del se viti i lindjes është viti 1414, pra ai nuk ka lindur në vitin 1405. Kjo bazohet në rreth njëzet fakte, por unë po përmendi më kryesoret; 1- Si ka mundësi që Gjergj Kastrioti Skënderbeu të lindë në vitin 1405 dhe të merret peng nëntëvjeçar ndërsa të jetë Sulltan Murati II, kur dihet se ai vjen në pushtet në vitin 1421 dhe e nënshtron Shqipërinë dy vite më vonë. (23 minus 9 është 14 (2014). Fakti i dytë: Josef von Hammer, historiani më i njohur i perandorisë osmane, i cili ka shkruar dhe mësohet në Turqi dhe të gjitha vendet, thotë se kur u kthye Skënderbeu në Krujë ishte 29 vjeçar, pra viti 1443 minus 29 del viti i lindjes 1414. Gjithashtu kronika arabe të cilën e kam zbuluar unë për herë të parë e përkthyer në gjermanisht nga gjuha arabe në vitin 1680 nga Loschke, aty bënë fjalë për jetën e Skënderbeut që është vëzhguar nga një agjent arab në pallatin mbretëror të sulltanit, dhe, aty dy-tre vite e ka vëzhguar Skënderbeun. Ai në shkrimet e tij tregon për dashurinë e Skënderbeut me sulltaneshën e katër të sulltanit e cila ka qenë vajza e Brnkoviqit, e quajtura Maria, por arabi nuk ia di emrin dhe i thotë Servilia, në gjuhën latine Serbisë i thonë Servilia, pra të gjitha këto dokumente pa i përmendur faktet tjera, dëshmojnë se Skënderbeu ka jetuar 53 vjet, pra ai ka lindur në vitin 1414. Skënderbeu ka qenë një personalitet i përsosur, është krenari kombëtare dhe është i përmasave ndërkombëtare". Libri u promovua në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", në Has dhe pritet të organizohet promovimi në Austri dhe vende tjera. Prof. Dr. Eqrem Zenelaj është sot figurë e njohur në historiografi dhe diplomaci me përmasa ndërkombëtare. Nga puna hulumtuese e tij rrodhën dhjetë vepra shumë interesante të bazuara në fakte e dokumente nga arkivat dhe bibliotekat më të njohura të botës. Njeriu i bibliotekave dhe arkivave, njeriu ynë, Nderi i Kombit.



Eqrem M. Zenelaj

ALBUM HISTORIK KOMBËTAR
NATIONAL HISTORICAL ALBUM

(ME RASTIN E 550-VJETORIT TË VDEKJES SË HEROIT KOMBËTAR SHQIPTAR)
(ON THE OCCASION OF MARKING THE 550th ANNIVERSARY OF THE DEATH OF THE ALBANIAN NATIONAL HERO)

GJERGJ KASTRIOTI-GIORGIO KASTRIOTA
SKËNDERBEU
SCANDERBEG

(në veprat e artistëve evropianë dhe burime të vjetra arkivore)
(in the works of European artists and old archival sources)



Prof. Dr. Eqrem
Zenelaj,

markante të shekullit të pesëm-bëdhjetë të Europës. Libri ka shumë të veçanta, një nga ato kryesore është portreti i parë i Gjergj Kastriotit, i cili është në ballinë dhe nga ky portret janë marr të gjitha portretet tjera. Ky portret është një gravurë, gjegjësisht një pikturë e punuar 450 vjet më parë e cila gjendet në Muzeun Historik të Arteve në Vjenë. Të tjera të veçanta janë shumica e pikturave, e portreteve shumica e tyre të papara deri me sot e të pa njohura për publikun.

E rrallë

Ta ndërtosh shtëpinë për gjashtë orë

Të ndërtosh një shtëpi, përveç parave, kërkon edhe një angazhim dhe një kohë të gjatë deri në përfundim. Të paktën shqiptarët këtë gjë e kanë vuajtur ndër vite. Por një kompani në Itali kërkon të revolucionarizojë ndërtimin e shtëpive dhe është e specializuar për ndërtimin e një banese për vetëm gjashtë orë. Mjaftojnë vetëm tre persona dhe materiali, i cili është gjysmë i gatshëm dhe shtëpia është gati brenda gjashtë orëve.



FOTO E DITES



Një grup emigrantësh nga Amerika Qendrore shihen në lumin Suchiate ndërmjet Guatemalës dhe Meksikës. /AP/

E jashtëzakonshme

Hoteli i mahnitshëm në formë kitare

Një hotel i ri në formë kitare dhe i lartë 138 metra po ndërtohet në Florida. Por, si çdo projekt, ka persona që mezi e presin, duke thënë se do t'i japë shtysë të mëtejshme turizmit, por ka edhe prej atyre që thonë se ky hotel është i shëmtuar dhe aq i madh sa mund të shikohet nga hapësira.



BARSOLETA E DITËS



Dy shokët:
 - Kur të rritem kam dëshirë të bëhem milioner si babi!
 - Pse, a babin milioner e ke a?
 - Jo, por edhe ai ka pasur dëshirë të bëhet milioner!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
 Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
 Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
 Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
 Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
 Regjia: Ruben Fleischer
 Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.

 <p>DASHI E sotmja do të jetë një ditë interesante, plot surpriza dhe ndryshime programi në çastet e fundit.</p>	 <p>DEMI Keni shumë gjëra të pazgjidhura me një koleg dhe kjo gjë do t'ju pengojë të nisni bashkë një projekt të ri dhe fitimprurës.</p>	 <p>BINJAKËT Keni lënë që persona të tjerë t'ju faturojnë probleme dhe punë të pazgjidhura. Situata ka degraduar çdo ditë e më shumë.</p>	 <p>GAFORRJA Keni lënë pas dore disa çështje të rëndësishme familjare. Nuk jeni marrë sa duhet me ato detaje që mund ta bëjnë diferencën.</p>	 <p>LUANI Sot mund të zgjidhni nga disa variante që do t'ju ofrohen. Sigurisht zgjedhja juaj do të jetë ajo më e mira dhe më e saktë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Jeni shumë të mërziur sot me një person që ju ka premtuar hënën, por nuk ka mbajtur asnjë nga premtimet e veta.</p>
 <p>PESHORJA Nëse sot nuk keni vendosur se çfarë do të bëni me një projekt tuaj, është mirë të mos kërkonit zgjidhje nëse nuk keni ndarë më parë idenë.</p>	 <p>AKREPI Edhe pse ka diçka që ju shqetëson sot, jeni mësuar me këtë ndjenjë dhe mund të bashkëjetoni shumë të qetë.</p>	 <p>SHIGJETARI Mos jini shumë të bindur mbi çka po bëni sot, sepse kritikë që do të merrni do të vijnë edhe nga miqtë tuaj.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni treguar shumë të kujdesshëm me çdo person që ka kërkuar ndihmën tuaj. Mbase sot duhet të hiqni dorë dhe të merreni me veten.</p>	 <p>UJORI Sot qëndroni larg qëndrimeve të prera dhe mos jepni vendime përfundimtare. Me vonë do të pendoheni për këtë gjë.</p>	 <p>PESHQIT Do të bëni çdo gjë me kujdes sot dhe hapat që do të hidhni do të jenë konkretë dhe të argumentuar mirë.</p>

Era Istrefi publikon një pjesë të këngës së re



Këngëtarja e mirënjohur Era Istrefi në llogarinë e vet në "Instagram" ka publikuar një insert duke kënduar e që mendohet të jetë kënga e saj më e re. Disa ditë më parë është raportuar se ajo është

duke punuar me artistin e famshëm, Jonas Blues, në këngën "Purpose". Istrefi ka pasur një sezon të suksesshëm gjatë këtij viti që po e lëmë pas, duke publikuar këngë që u bënë shumë shpejt hite.

Pse Heidi Klumi është mbretëresha e Halloweenit



Tashmë duket se është pranuar nga të gjithë që askush nuk e merr Halloweenin më seriozisht se Heidi Klumi sa iu përket kostumeve. U bënë shumë vite tashmë që ajo i lë të gjithë gojëhapur me

kostumet e sofistikuara, aq sa ka marrë titullin mbretëresha e Halloweenit. Modeluesja gjermane, nënë e katër fëmijëve, e organizoi festën e parë të Halloweenit në vitin 2000 dhe çdo vit ka qenë më ekstravagant se tjetri.



Me kë e festoi David Fosteri ditëlindjen?

Katharine McPhee është fotografuar me një tufë lulesh duke dalë nga një restorant me të fejuarin e saj David Foster pas një dreke ditëlindjeje të enjten në Beverly Hills, Kaliforni. David ka

festuar ditëlindjen e 69 atë pasdite, i shoqëruar nga Katharine dhe disa miq të tyre. Katharine është aktualisht në pushim vokal pasi duhej ta anulonte turneun e ardhshëm për shkak të lodhjes ekstreme vokale.

Rusia ndalon transmetimin e filmit hollivudian "Hunter Killer"

"Hunter Killer" është një film rreth një kapiteni të papërvojë të nëndetës amerikane, e cila, në bashkëpunim me njësitë speciale në ujërat e Artiktës, arrin të shpëtojë presidentin rus. Në film presidenti i Rusisë është një peng i terroristëve rusë që përgatisin grushtshtetin dhe kërcënojnë provokimin e Luftës së Tretë Botërore. Filmi i regjisorit Donovan Marsh, i cili është një adaptim i librit "Firing Point", me



yjet si Gary Oldman, do të shfaqej në 850 kinema në Rusi. Filmi u ndalua më parë në Ukrainë për shkak të tensioneve ruso-ukrainase.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE BRENTFORD - MILLWALL 2 BOURNEMOUTH - MAN UTD GG3+ AUGSBURG - NURNBERG 1

Humbja nga Prishtina, e papranueshme për Drenicën

Qemail Elshani e ka vlerësuar ndeshjen ndaj Prishtinës si të vështirë, por beson se skuadra e Drenicës do të marrë rezultat pozitiv. Ndërsa mesfushori Diar Miftaraj ka thënë se skuadra kuqezi është e papërshtatshme për Prishtinën, por në Skenderaj synohen tri pikët e plota

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Mesfushori Qemail Elshani e vlerëson ndeshjen e KF Drenica kundër Prishtinës si të fortë, por është optimist se kuqezinjtë do të dalin të pamposhtur. Ndeshja në mes të këtyre dy skuadrave do të zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj. "Duke pasur parasysh një fillim kampionati të mirë dhe duke u bazuar në filozofinë e lojës që jemi duke aplikuar, kemi besim se do të dalim me rezultat pozitiv nga takimi me Prishtinën, edhe pse kundërshtari ynë është duke treguar lojëra të mira dhe duket një Prishtinë më ndryshe në ndeshjet e fundit. Normalisht se ky kundërshtar e gëzon respektin maksimal, pasi është klubi më traditë në vend. Ne jemi përgatitur mirë të luajmë kujdesshëm pasi nuk na lejohet të gabojmë në shtëpi, sepse kjo do të ndikonte edhe në ndeshjet që i kemi në vazhdim", ka thënë Elshani për "Epokën e re".

"Qema" në të kaluarën ishte pjesë e Prishtinës, kurse ka djersitur fanellën edhe të Feronikelit dhe Besës së Pejës. Lidhur me ndeshjen që zhvillohet në Skenderaj, ka folur edhe mesfushori i Prishtinës, Diar Miftaraj. Ish-mesfushori i Besës ka thënë se ndeshjet kundër Drenicës gjithmonë janë të vështira për skuadrën kryeqytetase, por këtë radhë Prishtina synon fitoren. "Normalisht, duke u bazuar në përballjet e sezonit të kaluar, kemi pasur vështirësi kundër ekipit të Drenicës, por këtë sezon jemi më në formë se në sezonin e vjetëm dhe ku dallojnë



edhe rrethanat e tjera. Tani po bëjmë edhe lojëra shumë më të mira. Po ndihemi shumë mirë në çdo aspekt. Jemi të përgatitur vetëm për ndeshjen pa menduar për ndeshjet e tjera. Shpresojmë vetëm në rezultat

pozitiv", ka thënë Miftaraj. Sot zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera: KEK-u - Flamurtari dhe Ballkani - Feronikeli. Tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të dielën.

IPKO SUPERLIGA	LIGA E PARË
Të shtunën takohen: Drenica - Prishtina KEK-u - Flamurtari Ballkani - Feronikeli	Fushë Kosova - 2 Korriku Drenasi - Vushtrria Dukagjini - Bashkimi (K) Ramiz Sadiku - Istogu Onix - Besa Vëllaznimi - Trepça Arbëria - Vitia Kika - Vllaznia
Të dielën takohen: Drita - Liria Trepça '89 - Gjilani Ferizaj - Llapi (Të gjitha ndeshjet fillojnë nga ora 13:30)	

SHKURT

Guardiola lavdëron portierin e Kosovës

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Arijanet Muriq, ka qenë titullar për Manchester Cityn në ndeshjen e Kupës ndaj Fulhamit (2-0). Pas kësaj ndeshje trajneri i Cityt, Pep Guardiola, e ka lavdëruar portierin e Kosovës për faktin që nuk ka pësuar gol. "Edhe një tjetër ndeshje pa pësuar gol e Arijanet Muriqi. Ne nuk shënuam shumë gola, edhe pse patëm shumë mundësi, por portieri ishte në nivel", ka thënë Guardiola.

Flamurtari vazhdon bojkotin

Skuadra e Flamurtarit vazhdon të mos stërvitet. Futbollistët e ekipit kryeqytetas kanë dy ditë që janë duke bojkotuar stërvitjet. Shkak për këtë është borxhi i kryesisë së klubit. Lojtarët ka dy muaj që nuk kanë marrë asnjë cent, andaj të revoltuar më këtë nuk kanë stërvitur as sot. Bojkoti do të vazhdojë derisa kryesia të reagojë me paga. Ndryshe, pavarësisht prej mungesës së mjeteve financiare, futbollistët e Flamurtarit qëndrojnë tejet mirë në renditje.

Më 6 nëntor shorti i Kupës në futboll

Të martën, më 6 nëntor, në orën 13:00, do të bëhet tërheqja e shortit për Digitalb Kupën e Kosovës. Komisioni i garave ka marrë vendim që në short të përfshihen 32 skuadra nga Superliga, Liga e Parë dhe Liga e Dytë. Për detajet e tjera klubet do të njoftohen para tërheqjes së shortit nga anëtarët e Komisionit të Garave.

Federeri, tri fitore larg trofeut të 100

Roger Federeri mposhti italianin Fabio Fognini 2-0, me sete 6-4 dhe 6-3, për ta siguruar biletën drejt çerekfinaleve të "Paris Masters", këtë të enjte. Legjenda zvicerane e tenisit mbetet vetëm tri fitore larg titullit të tij të 100 në karrierë. Federeri, 37 vjeç, i cili rrëmbeu trofeun e 99 në fushat e Bazelit javën e kaluar, do të përballlet me Kevin Andersonin nga Afrika e Jugut, ose Kei Nishikorin nga Japonia, ditën e premte, për të dueluar për një vend në gjysmëfinale të turneut të kryeqytetit francez. Federeri po luan për herë të parë në "Paris Masters" që prej vitit 2015, ndërsa në rast suksesi kjo do të jetë hera e dytë që fiton një turne të tillë, teksa për herë të parë e ka fituar në vitin 2011.

Sonte në "Sezai Surroi" përballen Bashkimi - Trepça

PRIZREN, 2 NËNTOR - Të shtunën në kuadër të xhros së shtatë në Superligën e Kosovës në basketboll do të ballafaqohen

Bashkimi - Trepça, duel ky që do të luhet me fillim nga ora 19:00 në palestrën e sportit "Sezai Surroi" në Prizren. Në

kuadër të kësaj xhiroje në program të dielën është ndeshja në mes të Golden Eagle Ylli - Borea që do të zhvillohet me fillim nga

ora 17:00 në palestrën "13 Qershori" në Suharekë, kurse dueli në mes të Ponte Prizrenit dhe Z Mobile Prishtinës është

shtyrë për shkak të obligimeve të ekipit bardhekaltër në garat evropiane, më saktësisht në FIBA Europe Cup.

Ministri Gashi: Do ta mbështes fuqishëm xhudon

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim xhudistet Nora Gjakova, Distria Krasniqi e Majlinda Kelmendi si dhe trajnerin Driton Kuka, njëherësh përzgjedhës i Kombëtares së Kosovës në xhudo. Ministri

Gashi i ka urrear xhudistet dhe trajnerin Kuka për prezantimin e suksesshëm të xhudos së Kosovës në Grand Slamin i cili është mbajtur në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe nga 27 deri 29 tetor. Ministri u shpreh se xhudistet bashkë me trajnerin Kuka me punën dhe

suksesin e tyre po e mbajnë në pedestal xhudon kosovare, por edhe po e promovojnë dhe forcojnë edhe imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. "MKRS-ja do ta mbështesë edhe më tutje dhe më fuqishëm sportin e xhudos në vendin tonë tashmë pas cilë-

sisë dhe talenteve që kemi në këtë sport duke e krijuar një traditë të rëndësishme", ka thënë Gashi. Xhudistet dhe trajneri Kuka e falënderuan ministrin për pritjen dhe për gatishmërinë e treguar që ta përkrahë sportin e xhudos në të ardhmen.



Gani Krasniqi, kryetar i Taekwondos

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Federata e Taekwondos së Kosovës ka zgjedhur organet e reja drejtuese në Kuvendin e Jashtëzakonshëm Zgjedhor, të thirrur nga Këshilli Iniciues, i dalë nga marrëveshja e arritur mes të gjitha klubeve aktive të këtij sporti.

Në Kuvendin e mbajtur të premten në sallën e Shtëpisë së Sportit në Prishtinë kryetar u zgjodh Gani Krasniqi, i cili mori 22 vota, asnjë kundër, asnjë abstenim. Nën kryetar u zgjodh Nuh Gashi, sekretar i përgjithshëm Enis Qafllashi. U zgjodh edhe Bordi Ekzekutiv prej shtatë anëtarëve. Të pranishëm në Kuvend ishin 11 klube me 22 delegatë. Kuvendi u vëzhgua edhe nga sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, anëtar i Bordit të KOK-ut, Ramadan Selimi dhe drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ibër Alaj, të cilët përshëndetën mbajtjen e këtij



Kuvendi dhe uruan drejtuesit e rinj, me shpresën se problemet maratonike të trashëguara prej vitësh kanë marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Kuvendi Zgjedhor i FTK-së u organizua pas ftesës së KOK-ut për të mbajtur një Kuvend të Jashtëzakonshëm Zgjedhor, si zgjidhja e vetme për t'i mënjeluar pakënaqësitë e mëdha. Pas më shumë se një dekade, komuniteti i taekwondos me

Kuvendin e mbajtur Zgjedhor është bërë unik, duke përfshirë të gjitha klubet aktive të këtij sporti, ndërsa prej tani të gjithë taekwondistët do t'i kenë mundësitë e barabarta. KOK përgëzon komunitetin e taekwondos për zgjedhjen e organeve të reja, duke iu urrear suksese drejtuesve të rinj dhe taekwondistëve të cilët do ta përfaqësojnë vendin tonë në gara ndërkombëtare.

Bostoni e njofton Milwaukeeen me humbje

BOSTON, 2 NËNTOR - Pas shtatë fitoresh radhazi, bie edhe skuadra e Milwaukee, e vetmja që nuk kishte pësuar asnjë humbje në NBA. Skuadra e Bucksit u mund 117-113 nga Bostoni, në një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Irvingu me 28 pikë ishte lider në fushë për Celticsin, ndërsa për Milwaukee nuk mjaftuan 33 pikët e 11 rebaunder e Antetokounmpo për ta evituar humbjen. Sërish humbje për Clevelandin, që u mund 110-91 nga Denveri, ndeshje me dy pamje: Më e mirë për Cavaliersin në të parën, ndërsa në të dytën erdhi përmbysja e Pistonsit. Hernangomez, që e nisi ndeshjen nga stoli, realizoi 23 pikë për Bostonin, duke qenë më i miri në fushë. Moment i mirë në kampionat për Oklahomën, që korri fitoren e tretë radhazi, duke mundur 111-107 Charlotte në fushën e kësaj të fundit. Sfidë emocionuese në minutat e fundit, me Westbrookun që realizoi 29 pikë e 10 asiste për Thunderin, mbështe-



tur edhe nga Schroderi me 21 pikë. Fitore të lehtë korri edhe Portlandi, që mundi 132-119 New Orleansin, me Lillardin që realizoi 26 pikë, suksesi i gjashtë për Portlandin, që ndodhet i treti në renditje në Perëndim. Skuadra e Sacramentos, falë 31 pikëve e 15 asisteve të Foxit, mundi 146-115 Atlanta në fushën e kësaj të fundit, ndërsa Philadelphia fitoi 122-113

ndaj Clippersit, ndeshje ku u dallua Embiid me 41 pikë e 13 rebaunder.

REZULTATET

Charlotte - Oklahoma	107-111
Cleveland - Denver	91-110
Philadelphia - Clippers	122-113
Atlanta - Sacramento	115-146
Boston - Milwaukee	117-113
Portland - New Orleans	132-119

SHKURT

Aliji, lojtar i Dinamo Bukureshtit

Naser Aliji do të jetë lojtari më i ri i Dinamos së Bukureshtit. Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë më në fund ka gjetur një ekip ku do të mund të luajë. Naser Aliji do të jetë lojtari më i ri i Dinamos së Bukureshtit. Në këtë mënyrë përfundon edhe periudha e gjatë e pritjes për mbrojtësin kuqezi, që do ta vazhdojë karrierën në elitën e futbollit rumun. Lajmi është konfirmuar nga trajneri i klubit, Mircea Redniq, që njoftoi se Aliji mund të cilësohet përfundimisht një lojtar i Dinamos së Bukureshtit. Për mbrojtësin 24-vjeçar do të nisë një aventurë e re, me një prej klubeve më të suksesshme në historinë e futbollit në Rumani, ku ka fituar 18 tituj kampionë dhe 13 kupa. Pas aktivizimit me Virtus Entellan gjatë sezonit të kaluar, Aliji ishte pa skuadër prej qershorit të kaluar, pasi vendosi të qëndronte pranë familjes, në muajt e fundit të jetës së babait të tij. Tani ai është gati për të luajtur dhe në një të ardhme të afërt mund ta shohim përsëri duke bartur fanellën e Shqipërisë.

Sërish lëndohet De Bruyne

Ylli i skuadrës kampione të Anglisë, Manchester Cityt, Kevin De Bruyne ka pësuar një tjetër lëndim. Mesfushori belg, në ndeshjen ndaj Fulhamit, pësoi një goditje në gju, duke u detyruar të largohet nga loja në minutën e 86. Shkalla e lëndimit të 27-vjeçarit nuk është bërë me dije ende nga stafi mjekësor i "Qytetarëve". Për De Bruyne kjo ishte ndeshja e tij e dytë si titullar, pas rikthimit nga lëndimi që e mbajti jashtë fushave për më tepër se dy muaj.

Pogba: Juventusit është shtëpia ime, kënaqësi të kthehem

Paul Pogba i "shkel syrin" Juventusit, pasi në një intervistë të dhënë për mediet angleze, ka pranuar se do të ishte një kënaqësi të rikthehej në Torino, ndonëse këto deklaratë i lidhi me ndeshjen e kthimit të Ligës së Kampionëve. "Juventusit është shtëpia ime, është vendi ku kam shënuar gola e parë si profesionist dhe kam kaluar momentet më të bukura. Do të jetë një kënaqësi të kthehem. Shorti është 'i çmendur', e kisha parandjerë që në fillim se do të ndodhte kështu", ka deklaruar Pogba. Më pas Pogba pranoi se ka miqësi dhe komunikon shpesh me disa prej futbollistëve të bardhezinjve, veçanërisht me Bonuccin, Cuadradon dhe Dybalën, ndërsa u shpreh se ka mësuar shumë nga lojtarë si Chiellini, Buffon e Pirlo.

Reali interesohet për Suson

Me 4 gola dhe 7 asistime, Suso është futbollisti më produktiv i Serisë A së bashku me Cristiano Ronaldon (7 gola dhe 4 asistime). Për këtë arsye, spanjollit i Milanit ka tërhequr vëmendjen e klubeve të mëdha evropiane, mes të cilëve edhe Real Madridi. Sipas "Sportmediaset", madrilenët janë gati ta paguajnë klauzolën e Susos, që Milani e ka vënë 40 milionë euro. Kjo ka vënë në alarm edhe drejtuesit e Milanit që kanë mbajtur disa takime me menaxherin e lojtarit, të cilit i kanë ofruar rinovimin me pagë më të lartë dhe me një klauzolë prej të paktën 60 milionë eurosh. Për Suson janë interesuar edhe Chelsea dhe Atletico Madridi.

Buffoni e vlerëson Messin si më të mirin në botë

Gianluigi Buffon nuk ka aspak dyshime se Lionel Messi është lojtari më i mirë në botë. Portieri italian këtë verë vendosi të ndryshojë mjedis, duke u larguar nga Juventusit në drejtim të Francës, te PSG-ja. "Favoritët në Ligën e Kampionëve? Duhet të themi Barcelona sepse ka në skuadër lojtarin më të mirë në botë. Pastaj Juventusit, që ka transferuar lojtarin tjetër që konsiderohet më i miri", ka deklaruar Buffoni.



EPOKA E RE		Autor: GAZMEND MORINA	SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET NDËRMJET TYRE (sh.shq.)	KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)	SHTËPIZË ME DËRRASA (sh.shq.)	AKTORJA ISMAILI	EPOKA E RE	NDENJËSE E GJATË	ZANORE	PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK (sh.shq.)	ASOCIAZIONE NAZIONALE ALOPECIA AREATA	CEREMONI FETARE	EDITA SOPJANI
		AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE JESSICA					LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK PIKË (ang.)						
		SHTET NË AFRIKË							KËNGËTARI POTOKU QYTET I MADH NË GJERMANI				
		KUKULLAT											APARTAMENT (sh.shq.)
		KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)										BASHKËT. RESTORANT, KAFE	
							PEABODY ESSEX MUSEUM THIKE E VOGËL XHEPI ME NJË PRESE				"LOS ANGELES" ANË E MPREHTË E NJË VEGLE		
		SHKENCA MBI MORALIN ZANORE		ZANORE IDRIZ BALAJ		KLUB BASKETBOLLI NË ITALI KUNDËRSHTARI I BOLSHEVIZMIT RUS							
		KALORËS MESJETAR						NOTË MUZIKORE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTES PORTIERI LIKA				
EPOKA E RE	FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (PSG)	TENISTJA SHARAPOVA	I PLOGËT	PESHA E MALLIT PA AMBALAZH	ELVIN ZAJMI	AZEM BEJTA LARTËSI QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË	SHTET NË AZI (pashq.) TERËSIA E VUJAVE QË BËHEN NË NJË ARË PËR TË UJITUR				NDESH FUTBOLLISTI GOKHAN (NAPOLI)		
	I SHQUAR, I DALLUAR											NOTË MUZIKORE VËNIA E DATËS NË KALENDAR	
	BANORI I NJË SHTETI SKANDINAV								BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA SKAJ MAGNETIK (sh.pashq.)			TREVISO VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE	
	IRNOSET (bised.)				KOMPOZITORI ITALIAN XHYZEPE				BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN KËNGËTARJA ANILA				ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE (sh.shq.)
	AKTORI AMERIKANE ROBERT DE				KËNGËTARJA ZAHARIA NDODHJE NË NJË VEND TJETËR NË ÇASTIN KUR ËSHTË KRYER NJË KRIM		QË LIDHET ME MONEDHËN FLETORË PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE						
				ALUMIN, AMPER, ZET GOJORE				DEVELOPMENT IN LITERACY BANKË QË OPERON NË KOSOVË		VARGU I PËRPUTHUR PRONË E VOGËL E SPAHINJVE OTOMAN (shq.)			
	PIKTORI VALLA ZANORE	RAMADAN (perkdh.)	OMANI, LIBERIA E TRAZOJ		VLERËSIM ME NOTË (sh.shq.) INSEKT I MËRZITSHËM (sh.shq.)						KRAHINË NË SHQIPËRI (pashq.) MËNYRË VEPRIMI (shq.)		
	NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË					GJENDJA FIZIOLOGJIKE E QENIEVE TË GJALLA KËNGËTARI WEBBE (shq.)			I BUKURI (bised.) IRISH FILM INSTITUTE				
	LLOJ BIME NARKOTIKE						TË BANUARIT (sh.pashq.) REVISTË QË BOTOHET NË SHQIPËRI					EMMA FAZZUOLI REGJISORJA GJONI (shq.)	
	ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE							SHKENCËTARI GJOTA (shq.) EMËR YNI MASHKULLI					ZANORE KUNDREJT I FORTI
	BASHKËT.	"KENIA" VIJA QË SHPIE UJIN NË MULLI			KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.) FUTBOLLISTI ABIDAL			TASH	QESËNDISËS ALBANOLOGIA DURHAM				
				E ÇMPREHE "L" NË MES TË DY "A"					JETA E QETË SHKRONJË GREKE				
	PJESA MË E LARTË E NJË MALI QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT					SHTEGTARE BRITMË E LOPËS				LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI DUKAT			
	VEÇIMI						SPIKERJA HARADINAJ ZANORE				INITIATIVE GLOBUS EUROPE ZANORE		
EPOKA E RE	SHKENCËTARI NJUTON (shq.)						E NJËSUAR, E BASHKUAR					UGANDA, TANZANIA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Hospital and University Clinical Service of Kosova
Universitetske Bolnicke Klinicke Sluzbe Kosova
Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerziteti Stomatološki Klinički Centar
Kosova – University Dentistry Clinical Center of Kosovo



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitive të nenit 4. dhe neni 5 të Udhëzimit (MPMS) Nr. 07/2017 Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, neni 15 dhe 21 të Statutit, Rregullorës mbi organizimin, Sistematizimin e vendeve të punës dhe në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 468/2 të dt. 02.11.2018 QKSUK shpall

K o n k u r s

për plotësimin e vendeve të lira të punës:

Titulli i punës: Punëtor i Sigurimit (2 pozita),
Nr.Ref: 03/2-2018-QKSUK
Njësia: Njësia Mbështetëse e DAQ-it
Orari i punës: 40 orë në javë
Koeficienti: H-79 /4.00
Nëpunësi mbikëqyrës: Kryeshefi i DAQ-it
Kohëzgjatja e Kontratës: Në kohë të pacaktuar

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

Jep palëve informata.
Udhëzon palët sipas nevojës.
Bën sigurimin e objektit.
